

## GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: **PAKr 603/15**

Më: **20 maj 2016**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov, në cilësinë e kryetarit dhe gjyqtarit raportues, pastaj gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe gjyqtari kosovar i Gjykatës së Apelit Driton Muharremi, në cilësinë e anëtarëve të kolegjit, me pjesëmarrjen e këshilltares ligjore të EULEX-it Vjollca Kroçi-Gërzhaliu, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën penale kundër të pandehurve:

- 1. N.K.**, i biri i xxx dhe i xxx, xxx i Kosovës, i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx, i xxx, i diplomuar në xxx, aktualisht i punësuar si xxx, me gjendje financiare të deklaruar si mesatare, me vendbanim në xxx, në pronësi të letërnjoftimit nr. xxx;
- 2. A.Z.**, i biri i xxx dhe i xxx, xxx i Kosovës, i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx, i xxx, i diplomuar në xxx, aktualisht xxx, xxx, me gjendje financiare të deklaruar si të mirë, me vendbanim në xxx, komuna e xxx, në pronësi të letërnjoftimit nr. xxx;
- 3. S.H.**, i biri i xxx dhe i xxx, xxx i Kosovës, i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx, i xxx, i diplomuar në xxx, aktualisht xxx, me gjendje financiare të deklaruar si të mirë, me vendbanim në xxx, në pronësi të letërnjoftimit nr. xxx;
- 4. S.F.**, i biri i xxx dhe i xxx, xxx i Kosovës, i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx, i xxx, i diplomuar në xxx, me gjendje financiare të deklaruar si mesatare, me vendbanim në xxx, në pronësi të letërnjoftimit nr. xxx.

Të gjithë fillimisht të akuzuar me aktakuzën PPS Nr. 30/10, të datës 5 nëntor 2012, dhe të ndryshuar me aktakuzën e datës 28 mars 2013, ndërsa tani të akuzuar me veprat penale në vazhdim (sipas aktakuzës së ndryshuar dhe tërheqjes nga ndjekja penale gjatë fjalës përmbyllëse për akuzat e Mashtrimit në detyrë, në kundërshtim me nenin 341 (1) dhe (3), lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012:

### **1. N.K:**

- (pika një) Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së;
- (pika dy) Marrje e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343 (1), të Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012;

- (pika tre) Lidhje e kontratës së dëmshme, në kundërshtim me nenin 237 (1) dhe (2) të Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012;

## **2. A.Z.:**

- (pika një) Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së;

## **3. S.H.:**

- (pika një) Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së; dhe

- (pika dy) Marrje e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343 (1), të Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012;

## **4. S.F.:**

- (pika një) Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së; dhe

- (pika dy) Marrje e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343 (1), të Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012;

## **5. H.B.:**

- (lidhur me pikën dy) Dhënie e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 429 të KPK-së dhe
- (lidhur me pikën një) Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi, në kundërshtim me nenin 236, (1.2) dhe (2), të Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012;

Të gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Prishtinës me Aktgjykimin PKR 144/13, të datës 21 shtator 2015, me të cilin:

Të pandehurit: **N.K** në cilësinë e xxx në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (në vazhdim: MTI); **A. Z.** në cilësinë e xxx në MTI; **S.F.** në cilësinë e xxx në MTI si dhe **S.H.** në cilësinë e xxx në MTI, janë shpallur fajtorë (për pikën një të aktakuzës) për veprën penale Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së, ngase është provuar se kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare dhe e kanë dëmtuar buxhetin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në vlerë mbi 2.500 euro dhe se pagesa në fjalë rezulton në përfitim material për kompaninë xxx që kalon vlerën prej 5.000 euro. Pas auditimit të brendshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2007 nga tash i pandehuri **A.Z.**, është kërkuar nga operatori ekonomik xxx, pronë e **H.B.**, që ta kthejë shumën e lartpërmendur në vlerë prej 50,000 eurosh, prej të cilave vetëm 5.000 euro janë kthyer nga i pandehuri **H.B.**, më datën 10/04/2007. Të pandehurit asokohe mbanin pozita zyrtare në MTI dhe përmes akteve, veprimeve dhe lëshimeve të tyre të përbashkëta, ata i shkelën detyrat e tyre dhe

kontribuuuan ndjeshëm në kryerjen e veprës penale në fjalë. Në atë kohë, të pandehurit në fjalë janë sjellë ashtu siç është përshkruar më lart, duke qenë në gjendje për t'i kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tyre, të cilat i kanë dëshiruar, duke e ditur se këto veprime kanë qenë të ndaluara dhe të dënueshme me ligj.

Sa i përket pikës një, në përputhje me dispozitat ligjore në fjalë, në kuptim të neneve 359, 360 (2), 361 dhe 363 (3) të KPP-së, gjykata ka gjetur se i pandehuri **H.B.** ka kryer një pjesë të akteve për të cilat është akuzuar. Për këtë arsye, në mungesë të një prej elementeve të veprës përbërëse të keqpërdorimit të autorizimeve ekonomike, gjykata e shkallës së parë, në bazë të nenit 360 (2) të KPP-së, i ka ricilësuar aktet e kryera nga i pandehuri **H.B.** në vepër penale të Falsifikimit të dokumenteve – në bazë të nenit 332 (1) të KPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012; në bazë të nenit 90 (1) (6) të KPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar se afati i parashkrimit është dy vjet ndërsa ndalimi absolut për ndjekjen penale të veprës së falsifikimit të dokumenteve është katër vjet, në përputhje me nenin 91 (6) të KPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, prandaj ky afat prej katër vjetësh tashmë ka skaduar më datën 21/07/2010, për arsye se dokumenti më i vonë në shkresat e lëndës në fjalë e mban datën 21/07/2006. Sipas gjykatës së shkallës së parë, afati i përmendur kishte skaduar madje para datës në të cilën prokurori e kishte nxjerrë aktvendimin për fillimin e hetimeve, më 10/12/2011. Për këtë arsye, në përputhje me nenin 363 (1.3) të KPP-së, gjykata e ka refuzuar akuzën në fjalë.

Për pikën dy të akuzës, të pandehurit **N.K.**, **S.H.** dhe **S.F.**, janë shpallur të pafajshëm për veprën penale të Marrjes së ryshfetit, në kundërshtim me nenin 343 (1) të KPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, për shkak se nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të akuzuarit në fjalë i kanë kryer aktet për të cilat janë akuzuar;

Lidhur me pikën 3, gjykata e ka shpallur fajtor të pandehurin **N.K.**, pas ricilësimit të veprës penale të Lidhjes së kontratës së dëmshme, në kundërshtim me nenin 237 (1) dhe (2) të KPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012; pasi që faktet e vërtetuara nuk përputheshin me të gjitha elementet thelbësore të kësaj vepre penale, por ishin pjesë përbërëse e veprës penale më të lehtë Keqpërdorim i pozitës zyrtare ose i autoritetit zyrtar, e kryer në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së.

Me aktgjykimin PKR 144/13, të datës 21 shtator 2015 të pandehurit **N.K.**, **A.Z.**, **S.H.** dhe **S.F.** janë dënuar si më poshtë:

Për pikën 1: veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së, në kuptim të neneve 41, 45 dhe 73 të KPK-së:

- a) I pandehuri **N.K.** është dënuar me 12 muaj burgim;
- b) I pandehuri **A.Z.** është dënuar me 10 muaj burgim;
- c) I pandehuri **S.H.** është dënuar me 8 muaj burgim, ndërsa

d) I pandehuri S.F. është dënuar me 7 muaj burgim.

Për pikën 3: vepra penale Keqpërdorim i pozitës zyrtare, në kundërshtim me nenet 422 (1) dhe (2. 1) të KPK-së, i pandehuri **N.K** është dënuar me 18 muaj burgim. Dënimi unik për të pandehurin **N.K** është caktuar të jetë 26 muaj burgim për kryerjen e dy veprave penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Lidhur me të pandehurit **A.Z., S.H., S.F.**, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur të dënimet në fjalë nuk do të ekzekutohen nëse personat e dënuar nuk kryejnë vepra tjera penale gjatë periudhës verifikuese në kohëzgjatje prej dy vjetësh.

Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesën pasurore juridike të parashtruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë pasi që shumica e kërkuar ishte objekt i padisë civile e cila tashmë ishte vendosur përmes aktgjykimit të formës së prerë;

*Për këtë arsye*, Gjykata e Apelit (në vazhdim Gj/A), vendos lidhur me këto ankesa, të parashtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144 /13, të datës 21 shtator 2015:

1. Ankesa e mbrojtësit Bajram Tmava në emër të të pandehurit **N.K** e datës 20 tetor 2015, e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 22 tetor 2016;
2. Ankesa individuale e të pandehurit **N.K** e datës 23 tetor 2015, e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 23 tetor 2015;
3. Ankesa e mbrojtësit Hasim Loshi në emër të të pandehurit **A.Z.** e datës 26 tetor 2015, e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 29 tetor 2015;
4. Ankesa e mbrojtësit Sadri Godanci në emër të të pandehurit **S.H.** e datës 23 tetor 2015, e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 26 tetor 2016;
5. Ankesa plotësuese e mbrojtësit Sadri Godanci dhe e të pandehurit **S.H.** e datës 13 nëntor 2015, e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 13 nëntor 2015;
6. Ankesa e mbrojtësit Destan Rukiqi në emër të të pandehurit **S.F.** e datës 23 tetor 2015, e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 26 tetor 2016;
7. Ankesa individuale e të pandehurit **S.F.** (nuk ka datë), e vulosur nga Gjykata Themelore e Prishtinës më 26 tetor 2016.

*Pas marrjes parasysh të propozimit të prokurorit të apelit PPA/I. nr. 573/15 të datës 18 dhjetor 2015;*

*Pas mbajtjes së seancës publike të kolegjit më 13 maj 2016, në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP);*

*Pas këshillimit dhe votimit më 20 maj 2016;*

*Në pajtim me nenet 401 dhe 403 të KPP-së;*

*E merr këtë:*

## **A K T G J Y K I M**

---

**I. Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e mbrojtësit Bajram Tmava, e parashtruar në emër të të pandehurit N.K si dhe ankesa individuale e të pandehurit N.K kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144/13, të datës 21 shtator 2015.**

**II. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144/13, i datës 21 shtator 2015, lidhur me akuzat dhe dënimin e të pandehurit N.K ndryshohet si më poshtë:**

**I pandehuri N.K shpallet fajtor për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, në vazhdimësi me bashkëkryerës ndaj të cilëve nuk është ngritur aktakuzë, sipas nenit 422 të KPK-së, në kuptim të neneve 81, 41, 45, 73, dhe 31 të KPK-së.**

**Gjykata e cakton dënimin prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. Ky dënim nuk do të ekzekutohet në përputhje me nenin 51 të KPK-së, po qe se të pandehurit nuk kryejnë veprë penale gjatë periudhës verifikuese prej dy vjetësh duke filluar nga data kur aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë.**

**Konfirmohet pjesa tjetër e aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144/13, i datës 21 shtator 2015, lidhur me të pandehurin N.K;**

**III. Pranohen këto ankesa: ankesa e mbrojtësit Hasim Loshi në emër të të pandehurit A.Z.; ankesa e mbrojtësit Sadri Godanci në emër të të pandehurit S.H.; ankesa e mbrojtësit Destan Rukiqi në emër të të pandehurit S.F. si dhe ankesa individuale e të pandehurit S.F..**

**IV. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144/13, i datës 21 shtator 2015, lidhur me të pandehurit A.Z., S.H. dhe S.F., ndryshohet si më poshtë:**

**1. Në bazë të nenit 364 të KPP-së, të pandehurit A.Z., S.H. dhe S.F. LIROHEN nga të gjitha akuzat e kryerjes së veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës**

apo autoritetit zyrtar, të kryer në bashkëkryerje (në kundërshtim me nenin 422, par.1, lidhur me nenin 31 të KPK-së);

2. Të pandehurit **A.Z., S.H.** dhe **S.F.** lirohen nga obligimi për t'i paguar shpenzimet e procedurës, të përcaktuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144/13, të datës 21 shtator 2015.

---

## A R S Y E T I M

### I. PROCEDURA E DERITANISHME

Hetimet kundër të pandehurve kanë nisur më datën 05/04/2008, kur Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës ka dorëzuar në PSRK informatën lidhur me sjelljen e mundshme korruptuese ndaj të dyshuarve **B. D., B. Z.** dhe **N.K.**

Më 15/11/2008, Policia e Kosovës ka parashtruar në prokurori kallëzimin penal, “2011-XI-248”, kundër të pandehurve **N.K, A.Z., S.H., S.F.** dhe **H.B.**, me dyshimin e bazuar se kanë kryer vepra penale.

Më 10/12/2011<sup>1</sup> prokurori Besim Kelmendi ka nxjerrë aktvendimin për nisjen e hetimeve kundër të pandehurve të sipërpërmendur, **N.K, A.Z., S.F., S.H.** dhe **H.B.**, për veprat penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit, sipas nenit 339 (3), lidhur me nenin 23 të KPPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, Përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, sipas nenit 340 (3), lidhur me nenin 23 të KPPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, ndërsa më 21/05/2012, PSRK-ja ka nxjerrë aktvendimin për zgjerimin e hetimeve ndaj të pandehurve **N.K** dhe **S.F.**, duke e përfshirë edhe veprën penale Marrje e ryshfetit, sipas nenit 343 (1) të KPPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012 ndërsa kundër **H.B.** edhe veprën penale Dhënie e ryshfetit, sipas nenit 344 (1) të KPK-së. Më datën 20/07/2012 është marrë aktvendimi tjetër për zgjerim të hetimeve edhe ndaj **N.K**, për veprën penale Lidhe e kontratës së dëmshme, sipas nenit 237 (2), lidhur me nenin (1) të KPPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012, ndërsa kundër **H. B.** për Keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi, sipas nenit 236 (1) 2) dhe (2) të KPPK-së që ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012.

Të pandehurit fillimisht janë akuzuar nga PSRK-ja përmes aktakuzës PPS nr. 30/10 të datës 05/11/2012, e cila pastaj është ndryshuar lidhur me dispozitat përkatëse të kodit penal që kishte hyrë në fuqi më 01/01/2013, pasi që PSRK-ja ishte e mendimit se disa prej dispozitave të reja do të ishin më të favorshme për të pandehurit.

---

<sup>1</sup> Jo më 2012, siç theksohet gabimisht në arsyetimin e aktakuzës.

Shqyrtimi fillestar është mbajtur më 28/03/2013 ndërsa më 18/06/2013 – janë marrë deklaratimet e të pandehurve dhe të gjithë janë deklaruar të pafajshëm për secilën pikë të aktakuzës.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor, të hapura për publikun, janë mbajtur më 14 prill 2014, më 13, 14, 27 dhe 28 maj 2014, më 4 dhe më 5 qershor 2014, më 16, 17 dhe 18 korrik 2014, më 12, 26 dhe 30 shtator 2014, më 4 nëntor 2014, më 12 dhjetor 2014, më 5 dhe më 23 janar 2015, më 16 shkurt 2015, më 17 prill 2015, më 22 qershor 2015, më 24 qershor 2015, më 31 gusht 2015 si dhe më 17 shtator 2015.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht i Gjykatës Themelore të Prishtinës, në mënyrë verbale është shpallur më 21 shtator 2015, në përputhje me dispozitat e përcaktuara me nenin 366 të KPPK-së, në praninë e prokurorit të PSRK-së, të pandehurve dhe të mbrojtësve të tyre.

Aktgjykimi në gjykatën e shkallës së parë, përkatësisht në Gjykatën Themelore të Prishtinës është shpallur në mënyrë verbale më 21 shtator 2015, në përputhje me dispozitat e përcaktuara me nenin 366 të KPP-së, në praninë e PSRK-së, të pandehurve si dhe mbrojtësve të tyre përkatës.

Mbrojtësit kanë ushtruar ankesa në emër të të pandehurve kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144 /13, të datës 21 shtator 2015. Përveç kësaj, të pandehurit **N.K** dhe **S.F.** kanë ushtruar edhe ankesa individuale.

PSRK-ja me propozimin e saj të datës 25 nëntor 2015 ka njoftuar se nuk do të parashtrojë përgjigje lidhur me ankesat e ushtruara në emër të të pandehurve<sup>2</sup>.

Prokurori i apelit ka bërë propozimin e tij PPA/I. nr. 573/15 më datën 18 dhjetor 2015.

Më 18 maj 2016, është mbajtur seanca publike e kolegjit të Gjykatës së Apelit, në praninë e të pandehurve, mbrojtësve të tyre përkatës, në mungesë të prokurorit. Këshillimi i kolegjit të apelit është mbajtur më 20 maj 2016.

## **II. PARASHTRESAT E PALËVE**

Kundër aktgjyqimit në fjalë, janë ushtruar këto ankesa:

### **1. Ankesa e mbrojtësit Bajram Tmava në emër të të pandehurit N.K**

Mbrojtësi në ankesën e tij pohon se gjykata e shkallës së parë, as në dispozitiv as në arsyetimin e aktgjyqimit nuk ka dhënë prova të mjaftueshme në pajtim me dispozitat ligjore. Gjykata e shkallës së parë ka interpretuar gabimisht dispozitat ligjore me të cilat rregullohen çështjet

---

<sup>2</sup> Dosja e gjykatës: Aktgjykimi dhe Ankesat

financiare dhe ligji mbi prokurimin. Ai më tutje thekson se, në bazë të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe ligjit mbi prokurimin publik (2003/17), klienti i tij nuk ka asnjë përgjegjësi lidhur me procedurën e pagesës. Mbrojtësi më tutje deklaron se MTI-së nuk i është shkaktuar asnjë dëm. Lidhur me shkeljen e ligjit penal, mbrojtësi thekson se gjykata e shkallës së parë e ka shkelur ligjin në dëm të klientit të tij pasi që gjykata nuk ka asnjë provë për ta provuar ekzistimin e veprave penale me të cilat akuzohet klienti i tij. Ai thekson se pasi që aktgjykimi në fjalë përmban vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me këtë është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit, prandaj asnjë dënim i caktuar në rrethana të tilla nuk mund të pranohet si dënim me bazë ligjore. Për këtë arsye, ai i propozon Gjykatës së Apelit që t'i miratojë ankesat e tija, ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën në rigjykim ose ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar të pandehurin **N.K.**

## **2. Ankesa individuale nga i pandehuri N.K**

I pandehuri në ankesë parashtron se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me veten dhe me arsyetimin e aktgjykimit. Ai parashtron se ka një kundërthënie lidhur me faktet vendimtare në mes të asaj çfarë paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe në deklaratat e dhëna gjatë procedurës. Kjo ka kontribuar në sjelljen e aktgjykimit të kundërligjshëm. Të drejtat e mbrojtjes janë shkelur. Ai më tej pohon se gjykata e ka shkelur nenin 7 të KPP-së duke mos i përfshirë faktet e rëndësishme të cilat shkojnë në favor të të pandehurit, përkatësisht, prokurori e ka larguar skicën e dëshmitarëve të përgatitur nga hetuesi i policisë së Kosovës Y.H. Gjukata e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përkatësisht nenin 31 të saj [e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pasi që trupi gjykues i gjykatës së shkallës së parë nuk ka kryer ekspertizë objektive dhe profesionale. Ai deklaron se mbrojtja ka kërkuar një ekspertizë objektive të prokurimit e cila është pamundësuar nga gjykata pa asnjë justifikim. I pandehuri **N.K** në ankesën e tij më tutje deklaron se gjykata e ka shkelur dispozitën e kodit penal me që dënimi për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare sipas nenit 422 të KPK-së një herë është caktuar të jetë 12 muaj burgim pastaj më vonë dënimi tjetër për të njëjtën vepër penale ka qenë edhe 18 muaj burgim shtesë. Ai parashtron se gjatë gjykimin nuk është provuar as nuk është pretenduar në aktgjykimin e kundërshtuar dashja me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore apo të dëmtimit të një personi tjetër si element i veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare në bazë të nenit 422 të KPK-së.

Lidhur me vërtetimin e gabueshëm të gjendjes faktike, i pandehuri në ankesën e tij pohon se gjykata ka bërë gabime gjatë vlerësimit dhe konstatimit të provave pasi që deklarata e dëshmitarit është ndryshe nga ajo çfarë është thënë në aktgjykimin e kundërshtuar.

I pandehuri pohon se aktakuzës i mungon shpjegimi i arsyeve të ngritjes së aktakuzës në bazë të rezultateve të hetimeve. Ai thekson se aktakuza përcakton se nuk ka prova të drejtpërdrejta. Madje dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor prokurori nuk ka arritur ta provojë ekzistencën e cilësdo vepër penale që është prezantuar në aktakuzën nr. PPS no.30/2010. I pandehuri më tutje thekson



se prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor disa herë e ka theksuar se i pandehuri është duke e shfrytëzuar të drejtën e vet për t'u mbrojtur në heshtje përderisa në fjalën përfundimtare ka theksuar se i pandehuri nuk e ka mohuar deklaratën e vet të dhënë gjatë fazës paraprake. Lidhur me këtë, gjykata nuk është dashur ta interpretojë heshtjen e tij si dobësi apo si fajësi të të pandehurit. Lidhur me shumën në vlerën prej 50 mijë eurosh, i pandehuri thekson se nuk është dashur të shpjegohet në mënyrën siç është shpjeguar nga prokurori për shkak se kjo shumë e parave është dashur të kthehej në buxhetin e MTI-së dhe jo të përfitohet ndonjë dobi pasurore prej saj.

### **3. Ankesa e mbrojtësit Hashim Loshi në emër të të pandehurit A.Z.**

Mbrojtësi i të pandehurit **A.Z.** në ankesën e tij e ka kundërshtuar aktgjykimin për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin. Në ankesën e vet, mbrojtësi në fjalë parashtron se i pandehuri ka deklaruar në të gjitha fazat e procedurës penale se nuk i kishte kryer veprat penale për të cilat akuzohej. Ai kurrë nuk e kishte vënë nënshkrimin e tij në faturën e kontestuar me numrin 39/06. Ai pretendon se dikush tjetër e kishte shfrytëzuar faksimilen e tij dhe e kishte nënshkruar faturën e kontestuar. Më tutje ai thekson se klienti i tij nuk kishte përfituar nga askush dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë e përcakton se të tjerë të pandehur kanë përfituar nga kjo punë. Mbrojtësi në ankesën e vet parashtron se pasi i pandehuri **A.Z.** nuk ka kryer asnjë krim, i njëjti nuk është dashur të dënohej. Për këtë arsye, i propozon Gjykatës së Apelit që t'i miratojë ankesat dhe ta lirojë të pandehurin apo ta kthejë lëndën në rigjykim në Gjykatën Themelore.

Së bashku me ankesën, mbrojtësi i ka parashtruar edhe vërejtjet përfundimtare të të pandehurit **A.Z.**, të cilat i adresohen kryetarit të trupit gjykues të gjykatës së shkallës së parë.

### **4. Ankesa e mbrojtësit Sadri Godanci në emër të të pandehurit S.H.**

Mbrojtësi i të pandehurit **S.H.** në ankesën e tij, e kundërshton aktgjykimin lidhur me arsyet e shkeljeve esenciale të KPP-së, vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimin mbi dënimin<sup>3</sup>. Ai thekson se klienti i tij nuk ka bashkëpunuar me të pandehurit e tjerë siç pohohet në aktgjykimin në fjalë. Ai e ka kryer detyrën e vet në përputhje me autorizimet. Mbrojtësi në fjalë më tutje parashtron se dyshimi i bazuar nuk është vërtetuar nga gjykata, duke thënë se klienti i tij e kishte nënshkruar urdhër pagesën pasi ajo ishte nënshkruar nga sekretari i përhershëm. Ai e kishte nënshkruar dokumentin në fjalë në mënyrë të ligjshme dhe të ndërgjegjshme pasi që në kontratë nuk parashihej asnjë pagesë paraprake dhe pasi që rasti në fjalë kishte kaluar nëpër shumicën e departamenteve përkatëse. Aktgjykimi i apeluar është i pabazë për shkak se përmban shkelje esenciale të dispozitave të KPP-së. Dispozitivi i tij është i

---

<sup>3</sup> Versioni origjinal në gjuhën shqipe i ankesës së parashtruar nga mbrojtësi i përmban të gjitha pretendimet për të gjitha arsyet, përderisa versioni i përkthyer në gjuhën angleze nuk e përmban pretendimin e mbrojtësit lidhur me ankesën për dënimin.

paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin. Mbrojtësi i propozon gjykatës së shkallës së dytë që ta lirojë të pandehurin **S.H.** apo ta kthejë lëndën në rigjykim.

#### **5. Ankesa individuale e të pandehurit S.H.**

I pandehuri ka theksuar në ankesë se e ka nënshkruar vetëm pagesën e dytë e cila i përfshinte vetëm punët e kryera dhe se kishte vepruar në përputhje me kontratën, pa e shkelur të njëjtën. Ai deklaroi se e kishte nënshkruar atë pasi ajo dukej si një pagesë për punët e kryera e jo si një pagesë paraprake. Ai më tutje thotë se dëshmitë e dëshmitarëve tregojnë se veprimet e tij nuk kanë qenë të qëllimshme. Ai më tej thekson se aktakuza është bazuar vetëm në deklaratat e të pandehur H.B. dhe A.Z.. Gjykatës së shkallës së dytë ai i propozon që ta analizojë dhe ta rishikojë lëndën në fjalë duke e liruar atë.

#### **6. Ankesa e mbrojtësit Destan Rukiqi për të pandehurin S.F.**

Në ankesën e vet, mbrojtësi në fjalë parashtrohet se aktgjykimi i kundërshtuar është i pabazë dhe i paqëndrueshëm juridikisht për shkak të shkeljeve esenciale të KPP-së, shkeljeve të kodit penal në dëm të të pandehurit dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në ankesë, mbrojtësi e apelon edhe vendimin mbi sanksionin penal.

Lidhur me shkeljet esenciale të KPP-së, përkatësisht shkeljen e nenit 384 (1) 1.12, par. (2) 2.1 të KPP-së<sup>4</sup> mbrojtësi në fjalë deklaroi se aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përpiluar në pajtim me nenin 370 (4) dhe (7) lidhur me nenin 365 (1) 1.1 të KPP-së që do të thotë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kundërthënës me veten. Aktgjykimi nuk përmban arsye të mjaftueshme që lidhen me faktet vendimtare për vendosjen e lëndës. Dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar i mungon përshkrimi faktik i veprimeve të cilat përbëjnë figurën e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare sipas nenit 422 të KPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 384 (2) 2.1, kur nuk i ka konsideruar si provë deklaratat e të pandehurve të cilët janë mbrojtur në heshtje gjatë fazës paraprake. I pandehuri **S.F.** ka qenë një prej të pandehurve të cilët janë mbrojtur në heshtje.

Sa i përket vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi parashtrohet se gjykata e shkallës së parë nuk e ka konfirmuar plotësisht dhe drejt gjendjen faktike, pasi që provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk janë vlerësuar një nga një as faktet konkrete nuk janë provuar siç kërkohet të bëhet me nenin 361 (2) të KPP-së. Nuk ka prova që tregojnë se i pandehuri **S.F.** ka qenë i ngarkuar me detyrën e mbikëqyrjes së projektit për ndërtimin e parkut industrial në Drenas as që ka nënshkruar ndonjë dokument të pagesës.

Sa iu takon shkeljeve të kodit penal në dëm të të pandehurit në fjalë, mbrojtësi thekson se nuk janë plotësuar kushtet për veprën penale keqpërdorim i pozitës zyrtare, sipas nenit 422 të KPK-së, prandaj çdo sanksion penal i shqiptuar kundër të pandehurit **S.F.**, do të ishte i kundërligjshëm.

---

<sup>4</sup> Versioni në gjuhën angleze i referohet gabimisht KPK-së .

Avokati mbrojtës në fjalë i propozon Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën e tij, ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar të pandehurin **S.F.** ose së paku ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

#### **7. Ankesa individuale e të pandehurit S.F.**

I pandehuri në ankesat e veta deklaron se aktgjykimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm, i padrejtë dhe i pabazë pasi që i njëjti i ka injoruar të gjitha provat shfajësuese dhe ka fabrikuar skenarë fajësues pa asnjë bazë ligjore, prandaj me këtë gjykata e shkallës së parë ia ka shkelur atij të drejtat juridike dhe kushtetuese për barazi përballë ligjit. Lidhur me këtë, i pandehuri pretendon se kontrata në mes tij dhe MTI-së, e datës 07/06/2004, së cilës i referohet aktgjykimi, nuk është prezantuar si provë në asnjë fazë të procedurës penale. Kjo provë ka qenë në favor të mbrojtjes dhe nuk është përfshirë në shkresat e lëndës as nuk është marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Lidhur me implementimin e pagesave që i janë bërë kompanisë 'xxx', i pandehuri iu referohet deklaratave të dëshmitarëve të prokurorisë me të cilat përjashtohet përgjegjësia e tij. Ai kërkon nga Gjykata e Apelit që ta lirojë duke u bazuar në provat dhe në ankesën e tij.

#### **8. Propozimi i prokurorit të apelit**

Prokurori i apelit në propozimin e tij deklaron se ai konstaton se ankesat në fjalë janë të pabaza pasi që pretendimet e mbrojtjes nuk janë të mbështetura në prova. Në ankesat e tyre, shkeljet e pohuara vetëm përshkruhen dhe referohen në një mënyrë mjaft abstrakte dhe të përgjithësuar pa asnjë provë, dëshmi, arsyetim apo ndonjë argumentim konkret dhe të justifikueshëm. Këto pretendime tashmë janë përsëritur gjatë seancave të mbajtura të shqyrtimit gjyqësor. Ai më tutje pretendon se aktgjykimi i kontestuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; dispozitivi i tij është i kuptueshëm, i qartë dhe nuk është kundërtënë as me arsyetimin as me përmbajtjen e aktgjykimit, siç pretendohet në ankesat në fjalë. Për më tepër, këto fakte vendimtare nuk janë në kundërshtim me provat e administruara dhe se gjendja faktike në aktgjykimin e kundërshtuar është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë. Për këto arsye, duke u bazuar në një gjendje të këtillë faktike të vërtetuar drejt, gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejt ligjin penal kur ka konstatuar se aktet e të akuzuarve vërtet përmbajnë elemente esenciale të veprave penale, për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar. Për këtë, gjatë shqyrtimit të dënimit, gjykata i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit që t'i refuzojë ankesat e të pandehurve si të paqëndrueshme.

### **III GJETJET E GJYKATËS SË APELIT**

#### **Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e kolegjit**

Në bazë të nenit 472 (1) të KPP-së, kolegji e ka rishikuar nëse është kompetent apo jo dhe pasi që nuk ka pasur kundërshtime nga palët, kolegji mjaftohet me këtë: në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë – Ligjit nr. 03/L-053, të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe të sqaruar përmes marrëveshjes së arritur në mes të Shefit të EULEX Kosovës dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka juridiksion mbi lëndën në fjalë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur rreth lëndës përkatëse në përbërjen e një gjyqtari kosovar dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it.

#### **Pranueshmëria e ankesave dhe e përgjigjes**

Gj/A konstaton se ankesat janë parashtruar brenda afatit nga persona të autorizuar, në përputhje me nenin 380 dhe me nenin 381 (1) të KPP-së, prandaj ato janë të gjitha të pranueshme.

#### **Cështjet meritorë të lëndës**

Kolegji i Gj/A-së do t'i adresojë pikat e dispozitivit në bazë të renditjes së theksuar më lart.

#### **Gjetjet e Gj/A-së në raport me të pandehurin N.K**

Në ankesën e ushtruar në emër të të pandehurit **N.K** pretendohet se ka pasur vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendim të gabueshëm mbi sanksionin penal.

#### **Pretendimi mbi vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike**

Lidhur me vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi thekson se materiali provues është vlerësuar në mënyrë të gabueshme.

Kolegji i apelit e përsërit se kur ligji e bën përkufizimin e shprehjeve “vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike” si dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike”, ai iu referohet gabimeve apo lëshimeve që lidhen me “faktet materiale” të cilat janë vendimtare për aktgjykimin e marrë.<sup>5</sup> Gjykata e Apelit do ta anulojë aktgjykimin vetëm nëse Gjykata Themelore ka bërë ndonjë gabim themelor gjatë vlerësimit të provave dhe vërtetimit të fakteve.

---

<sup>5</sup> B. Petric, në: Komentimet e neneve të Ligjit jugosllav të procedurës penale, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, par. 3.

Si parim i përgjithshëm, vlerësimi i provave duhet të mbështetet në ekzaminimin direkt dhe të menjëhershëm të dëshmime verbale dhe të deklaratave nga ana e kolegjit të gjyqtarëve. Të lexuarit e procesverbalit të provave të ekzaminuara në gjykim, sa do besnik dhe i saktë që mund të jetë, është gjithmonë një instrument më pak i besueshëm për vlerësimin e provave. Madje edhe ekzaminimi i dokumenteve dhe i provave të tjera materiale në përgjithësi është më i saktë në gjykim, për shkak se shpesh këto prova duhet të mbështeten dhe përbëhen nga elementë të tjerë që janë objekt i shpjegimeve verbale nga dëshmitarët dhe palët. Për këtë arsye, siç vërtetohet nga kjo gjykatë edhe në rastet e tjera<sup>6</sup>, *“është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet ta marrë parasysht gjetjen faktike të trupit gjykues për shkak se pikërisht trupi gjykues është në pozitën më të mirë për t’i vlerësuar provat”*. Kjo është në përputhje me standardin të cilin e ka zbatuar Gjykata Supreme ka qenë *“që mos t’i ndryshojë gjetjet e gjykatës që ka gjykuar çështjen, vetëm nëse provat në fjalë në të cilat është mbështetur gjykata që e ka gjykuar çështjen nuk janë pranuar nga asnjë tribunal i arsyeshëm faktik apo kur vlerësimi i tyre ka qenë tërësisht i gabueshëm”*.<sup>7</sup>

Duke i pasur në mendje këto që u thanë më lart, kolegji i ka analizuar me kujdes provat në këtë procedurë penale së bashku me arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore. Edhe pse aktgjykimi i kundërshtuar nuk është përpiluar në përputhje të plotë me këto standarde, kolegji i Gj/A-së e konsideron të kuptueshëm dhe mjaftueshëm të arsyetuar. Nëse lexohet së bashku me provat e tjera në shkresat e lëndës, ai ofron një pasqyrë të qartë të ngjarjeve të cilat pastaj i mbështesin gjetjet e Gj/A-së.

Kolegji më pastaj i ka rishikuar me kujdes argumentet e prezantuara në ankesë dhe në propozimin e prokurorit të apelit.

Kolegji i ka ekzaminuar në mënyrë të hollësishme gjetjet faktike në aktgjykimin e kundërshtuar (versionin në gjuhën angleze), dhe pajtohet në tërësi me gjetjet në fjalë. Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar i ka analizuar në detaje provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me të pandehurin N.K. Në pikëpamjen e kolegjit, gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkluzione të logjikshme gjatë vlerësimit të provave.

Zaten, kolegji i Gj/A-së konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri N.K ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së. Aso kohe, i pandehuri N.K e mbante pozitën e xxx në MTI. Nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në fjalë e ka keqpërdorur qëllimisht pozitën e tij duke e miratuar pagesën në vlerë prej 135.278,20 eurosh më

---

6 Aktgjykimi PAKR 1121/12, i datës 25/09/2012.

7 Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30.

datën 25/07/2006 për kompaninë 'xxx', e cila e kishte fituar tenderin për projektimin dhe ndërtimin infrastrukturës në parkun industrial të Drenasit. Nga kjo shumë nuk ishte zbritur shuma prej 50.000 eurosh, e cila i ishte paguar më herët kompanisë 'xxx' më datën 07.06.2006, si pjesë e shumës së përgjithshme prej 140.689,62 eurosh, në bazë të dokumentit të njohur si 'Situacioni i parë' të datës 31.05.2006, përkundër faktit se kontrata bazë në mes të MTI-së dhe kompanisë 'xxx' thekson 0% pagesë paraprake.

Është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri N.K pas shpalljes së tenderit më datën 22/07/2005 për "Projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës së parkut industrial në Drenas", në të cilin ishte përzgjedhur kompania "xxx", më datën 07/10/2005 e kishte nënshkruar kontratën për projektin në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si dhe kompanisë "xxx", të përfaqësuar nga H.B., në shumën prej 144.000 eurosh / me çmim për njësi prej 69.825,25 eurosh.

Kontrata në fjalë është ndryshuar me aneks-kontratën e parë të datës 20/07/2006, midis kompanisë "xxx" dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, e nënshkruar nga i pandehuri N.K në emër të ministrisë, në të cilën palët pajtoheshin në mënyrë të ndërsjellë për ndryshimin e kushteve të pagesës, ashtu që vlera e përgjithshme e kontratës do të jetë 1.730.000 euro (...). Pas këtij ndryshimi të kontratës përmes aneks-kontratës në fjalë të datës 20/07/2006, një tjetër aneks-kontratë ishte arritur midis Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nënshkruar sërish nga i pandehuri N.K dhe nga kompania "xxx", e përfaqësuar nga pronari i saj H.B., më datën 28/09/2006, në të cilën thuhej: "Duke e pasur parasysh faktin se palët e përmendura më lart kanë bërë kontratë mbi vazhdimin e punëve në projektin e parkut industrial në Drenas, bazuar në punët e kryera të cilat janë bërë pas aprovimit të kërkesës për procedurën e negociuar para shpalljes së kontratës me PPA, ne lidhim këtë aneks-kontratë (...) neni 1: Kontrata origjinale e datës 07/10/2005 si marrëveshje e ndërsjellë në mes të palëve, vlera e përgjithshme e së cilës është 1.730.000 euro (...) neni 2 Vlera e përgjithshme e aneks-kontratës do të jetë në shumën prej 14.580,00 eurosh (...)". Përkundër faktit se shuma e kontratës fillestare të datës 07/10/2005 është ndryshuar vetëm me aneks-kontratën e parë (neni 4 i saj), të datës 20/07/2006, një muaj përpara kësaj, më datën 20/06/2006, i pandehuri N.K tashmë e kishte parashtruar në Agjencinë e prokurimit publik, në pajtim me nenin 34, par. 3 (mes tjerash), të Ligjit mbi prokurimin nr. 2003/17, Kërkesën për shfrytëzimin e procedurave të kufizuara apo të negociuara për punët shtesë, në të cilën thuhej: "vlera e përafërt e kontratës: 1.700.000 euro, vlera e parashikuar: vlera e punëve shtesë: 14.580 euro", kur asokohe (më 20/06/2006) shuma e kontratës së datës 07/10/2005 (kontratës së vetme ekzistuese) kishte qenë 144.000 euro / çmimi për njësi 69.825,25 euro, e jo 1.700.000 euro. Duke vepruar kështu, kolegji i Gj/A-së konsideron se i pandehuri N.K bart përgjegjësi penale. Veprimet inkriminuese të përmendura më lart të kryera nga i pandehuri demonstronjë elemente substanciale të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, gjë e cila mbështetet në tërësi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Kolegji i Gj/A-së pajtohet plotësisht me gjetjen e Gjykatës Themelore se i pandehuri ka qenë në gjendje t'i kuptojë dhe t'i kontrollojë veprimet e veta, të cilat i ka dashur, duke e ditur se këto veprime ishin të ndaluara dhe të dënueshme me ligj. Nuk ka fije dyshimi se i pandehuri N.K e ka kryer qëllimisht veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, duke e pasur parasysh faktin, siç është përshkruar më lart se ka ndërmarrë veprime të kundërligjshme në disa raste duke e nënshkruar Marrëveshjen në emër të MTI-së si dhe dokumentet për pagesë për kompaninë 'xxx'.

Për këtë arsye, kolegji gjen se aktgjykimi në fjalë nuk përmban vërtetim jo të plotë ose të gabueshëm të gjendjes faktike. Për më tepër, Gjykata Themelore me të drejtë vjen në përfundimin logjik gjatë vlerësimit të secilës provë, duke e prezantuar në këtë mënyrë fajësinë e përgjithshme të të pandehurit në fjalë. Ankesa e mbrojtjes, prandaj, për këtë arsye, refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimi për shkeljen e ligjit penal**

Mbrojtësi i të pandehurit N.K, në ankesën e tij, e kundërshton vendimin në aktgjykimin e kundërshtuar për shpalljen fajtor të të pandehurit për dy vepra penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar.

Kolegji i Gj/A-së pajtohet me ankesën e mbrojtësit në këtë aspekt, ngase nga veprimet e të pandehurit, mund të konstatohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së. Kështu, nga veprimet inkriminuese të të pandehurit, mund të vërtetohet se i pandehuri N.K ka vepruar në vazhdimësi në mënyrë inkriminuese duke i plotësuar të gjitha kushtet e nenit 81 të KPK-së. Për këtë, kolegji i Gj/A-së e miraton ankesën në emër të të pandehurit duke konsideruar kështu se i pandehuri N.K e ka kryer veprën penale të theksuar më lart, në përputhje me nenin 81 të KPP-së. I pandehuri ka kryer vetëm një vepër penale të të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 81 dhe nenin 31 të KPK-së.

### **Vendimi mbi sanksionin penal**

Mbrojtësi në ankesën e tij thekson se pasi që aktgjykimi mbështetet në gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht, atëherë dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i kundërligjshëm.

Kolegji i Gj/A-së duhet t'i refuzojë këto pretendime, pasi që gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të justifikuar; për këtë arsye duhet të shqiptohet dënimi. Megjithatë, pas faktit se kolegji i Gj/A-së e vërteton cilësimin juridik të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar si vepër penale në vazhdimësi në bazë të nenit 81 të KPP-së, ai duhet ta theksojë

faktin se kjo ndikon edhe në dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë. Prandaj, dënimi është ndryshuar duke e dënuar të pandehurin N.K me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim. Duke e pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, sjelljen e kryerësit në të kaluarën, të kaluarën e pastër të tij, Gjykata e Apelit konstaton se qëllimi i dënimit në përputhje me nenin 41 të KPK-së do të arrihet me një dënim me kusht. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit i shqipton dënim me kusht të pandehurit N.K, i cili nuk do të ekzekutohet, sipas nenit 51 të KPK-së, po qe se i pandehuri nuk kryen veprë penale gjatë periudhës verifikuese prej dy vjetësh duke filluar nga data kur aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë.

### **Gjetjet e Gj/A-së lidhur me të pandehurin A.Z.**

Me aktgjykimin e kundërshtuar, i pandehuri A.Z. është shpallur fajtor për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, i kryer në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit A.Z., në ankesën e tij, e konteston aktgjykim për vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe lidhur me vendimin mbi dënimin.

Kolegji i Gj/A-së i konstaton të bazuara pretendimet ankimore në fjalë.

Bëhet e ditur se lënda në fjalë është iniciuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) me raportin e datës 15 prill 2008, duke u bazuar në informatat e dhëna në këtë agjenci. Duke u mbështetur në këtë informatë, AKK-ja ka bërë kallëzimin penal në prokurori e cila pastaj ka ngritur aktakuzën. Kolegji i Gj/A-së konstaton se aktakuza në fjalë nuk i specifikon veprimet inkriminuese të A.Z.; ajo më shumë i përshkruan ato me disa fjali të shkurtra. Nuk ka ndonjë faqe specifike e cila i kushtohet Adem Z. në aktakuzë për t'i përshkruar veprimet e tij kriminale.

Po qe se e lexojmë aktgjykimin e kundërshtuar dhe provat e prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, mund të konstatohet me lehtësi se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në interpretimin e provave dhe dëshmive të prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me përfshirjen e A. Z. në këtë veprë penale. Pikërisht gjatë seancës së 26 shtatorit 2014, Z. qartë e ka shpjeguar procedurën e cila është dashur të ndiqet pas kryerjes së pagesës. Ai thekson se në zinxhirin e personave që është dashur ta lejonin pagesën, në një mënyrë ai është kaluar si xxx. Dihet se A. Z. ka qenë ushtrues i detyrës së xxx nga data 18 maj 2006 deri më 26 nëntor 2006 që e mbulon periudhën e parregullsive gjatë pagesës së kompanisë 'xxx'. Pas tij, në pozitën e xxx ishte përzgjedhur B.Z. Pas përfundimit të mandatit të ushtruesit të detyrës së xxx, A.Z. ishte kthyer në punë në pozitën e xxx në bazë të planit të punës dhe një prej pikave të kontrollit ishte puna në parkun industrial të Drenasit. Duke e kryer auditimin e brendshëm në vitin 2008, A.Z. i kishte vërejtur parregullsitë në faturën me numër 39/2006 të datës 21 korrik 2006 në shumën prej 50.000 eurosh si pagesë paraprake si dhe nënshkrimin e tij të falsifikuar në dëftesën në fjalë. Shkresa për auditim i ishte sjellë atij nga ana e H.K., aso kohe në pozitën e xxx. Pasi i kishte parë



vërejtur parregullsitë dhe nënshkrimin e falsifikuar, ai e kishte informuar ministrin dhe ishin mbajtur disa takime, ndërsa N.K, xxx e kishte pranuar se kishte pasur një gabim me këtë pagesë.

A.Z. e sqaron se nënshkrimi i cili paraqitet në këtë dokument me të cilin zotohen fondet për projektin në fjalë, nuk është kontestues. Ai i shpreh shqetësimet e tija lidhur me nënshkrimin në faturën 39/06 të datës 21 korrik 2006, duke theksuar se në faturën origjinale pa datë, nënshkrimi i tij nuk paraqitet, përderisa më vonë fatura nr. 39/06 e datës 21 korrik 2006 e përmban nënshkrimin e falsifikuar. Ai e mohon bindshëm se ka nënshkruar ndonjëherë atë faturë pasi që ai kishte refuzuar ta nënshkruante pagesën në fjalë kur i ishte prezantuar derisa ishte në pozitën e ushtruesit të detyrës së xxx. Ai kishte refuzuar ta nënshkruante atë sepse pagesa ishte e kundërligjshme, siç theksohet në raportin e AKK-së (Agjencisë Kundër Korrupsionit).

Fatura e kontestuar nr. 39/06 e datës 21 korrik 2006 në shumën e përgjithshme prej 135,278.20 eurosh e përfshin edhe shumën e kontestuar prej 50.000 eurosh, e cila është dashur të kthehej në buxhetin e MTI-së. Në kohën sa ishte ushtrues detyre i xxx në MTI, ai e kishte pasur një aksident në Maqedoni ku e kishte lënduar krahun e djathtë dhe nuk mund të nënshkruante asnjë dokument me të. Me qëllim që mos ta ndalonte punën në MTI, ai e kishte bërë një faksimil me nënshkrimin e tij. Ai pretendon me bindje se ky faksimil pastaj është falsifikuar dhe shfrytëzuar në faturën e falsifikuar. Kjo përsëritet prej tij edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 26 shtator 2014 kur thotë se nënshkrimi i është shfrytëzuar pa dijen e tij apo është falsifikuar.

Përveç deklaratës bindëse të A.Z., asnjë prej dëshmitarëve nuk kishte deklaruar se ai i ka nënshkruar faturën e kontestuar 39/2006 me qëllim të përfitimit të ndonjë dobie për veten ose për dikë tjetër apo për t'i shkaktuar dëm dikujt tjetër apo për t'ia shkelur rëndë të drejtat e dikujt tjetër. Në këtë aspekt, prokurori nuk ka arritur ta provojë dashjen. Prokuroria nuk ka sjellë asnjë dëshmitar apo ndonjë provë bindëse për ta konfirmuar se i pandehuri A.Z. e ka nënshkruar faturën nr. 39/06 me qëllim të përfitimit të ndonjë dobie për veten ose për dikë tjetër apo për t'i shkaktuar dëm dikujt tjetër apo për t'ia shkelur rëndë të drejtat e dikujt tjetër. Kolegji i Gj/A-së konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se A.Z. e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Vepra penale e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar mund të bëhet vetëm qëllimisht, ndërsa mungesa e dashjes do të thotë mungesë e elementeve të kësaj vepre penale. Për këtë arsye, kolegji e miraton ankesën e parashtruar në emër të të pandehurit A.Z. dhe e liron atë.

### **Gjetjet e Gj/A-së lidhur me të pandehurin S.H.**

I pandehuri S.H. është shpallur fajtor për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së, pasi që, sipas aktgjykimit të kundërshtuar, duke qenë në cilësinë e zyrtarit certifikues, ai e ka aprovuar pagesën në vlerë prej 135,278.20 eurosh për kompaninë 'xxx', në të cilën shumë ishte edhe shumë prej 50.000 eurosh si pagesë paraprake.

Mbrojtësi i tij në ankesë e konteston aktgjykimin për shkak të shkeljes esenciale të KPP-së, shkeljeve të kodit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi dënimin.

Lidhur me të pandehuri S.H., kolegji i Gj/A-së vëren se në kohën kur ka ndodhur vepra penale, S.H. ka qenë në pozitën e xxx në MTI. Në kohën kur shuma prej 50.000 ishte lejuar të paguhej si pagesë për punët përfundimtare në faturën në vlerën prej 135,278.20 euroh, S.H. ishte duke e zëvendësuar me autorizim zyrtaren certifikuese B. S.. Ai ishte duke e zëvendësuar B. S. po ashtu edhe me autorizimin e shefes së tij M.B.. Lidhur me aktet e S.H.t, B.S. ka dëshmuar në cilësinë e dëshmitares në seancën gjyqësore të datës 4 qershor 2014. Nga ajo ishte kërkuar që ta shpjegonte procedurën e pagesës, ndërsa kjo dëshmitare kishte theksuar në mënyrë të qartë se pasi që të gjitha dokumentet e projekt pagesës ishin nënshkruar nga të gjitha autoritetet e nevojshme, edhe ajo do ta kishte certifikuar pagesën në fjalë. Pikërisht këtë e kishte bërë S. H.. Kolegji konstaton se aktet e tij nuk mund të cilësohen se janë kryer qoftë edhe nga pakujdesia. Ai ka vepruar kështu sepse, së pari ai ka qenë duke e zëvendësuar zyrtaren certifikuese B. S., së dyti: pagesa në fjalë si dhe dokumentet e tjera dukeshin të jenë ashtu siç duhet dhe se pagesa ishte nënshkruar nga xxx, që aso kohe nuk dihej për faktin e falsifikimit.

Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë nuk ka theksuar qartë se në çfarë prova të provuara bazohet akuza e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, nga i pandehuri në fjalë. Nuk ka as prova të drejtpërdrejta as deklarata të dëshmitarit për të treguar në drejtim të S.H.t që do të konfirmonte se ky ishte ai që me vetëdije e kishte nënshkruar dhe e kishte aprovuar faturën e parregullt, e cila e tejkalonte vlerën e lejuar dhe përmbante nënshkrimin e falsifikuar. Për këtë arsye, kolegji e pranon ankesën e ushtruar në emër të të pandehurit S.H. dhe e liron atë.

### **Gjetjet e Gj/A-së lidhur me të pandehurin S.F.**

I pandehuri S.F. është akuzuar nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së. Kundër aktgjykimit dënues të gjykatës së shkallës së parë, mbrojtësi ka ushtruar ankesë në emër të të pandehurit për shkak të shkeljes esenciale të KPP-së, shkeljeve të kodit penal në dëm të të pandehurit, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi dënimin.

Pas vlerësimit të tërësishëm të shkresave të lëndës, kolegji i Gj/A-së konstaton se ankesa në fjalë është e bazuar për të gjitha arsyet. Kolegji vëren se i pandehuri S.F., në kohën kur ishte kryer vepra penale në fjalë, ka qenë në pozitën e xxx në kuadër të MTI-së.

Nga shkresat e lëndës dhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, S.F. nuk duket se është personi përgjegjës për mbikëqyrjen e punëve në parkun industrial në Drenas. Është e

vërtetë se S.F. e ka nënshkruar kërkesën për zotimin e fondeve për projektin që i ishte adresuar M.B., por kjo gjë nuk i jepte atij autoritetin për mbikëqyrjen e punëve. Ky fakt është konfirmuar disa herë nga dëshmitarët gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe kolegji i Gj/A-së i konsideron plotësisht kredibile deklaratat në fjalë. Nëse iu referohemi deklaratave të dëshmitarëve A. P., N.G.dhe H. K., del shumë e qartë se organi mbikëqyrës i punëve të kryera në Parkun Industrial në Drenas prej kompanisë 'xxx', ka qenë kompania 'xxx', kompani kjo e kontraktuar nga MTI-ja. Zaten, punët e kompanisë 'xxx' në Parkun Industrial të Drenasit së pari janë mbikëqyrë nga inxhinieri i ndërtimitarisë H.B., ndërsa nga maji i vitit 2006, mbikëqyrjen e punëve e ka marrë kompania 'xxx'. Për më tepër, S.F. ka qenë vetëm shef i divizionit për zhvillim të ndërmarrjes dhe zhvillim regjional, nën ombrellën e departamentit për politika dhe zhvillim të sektorit privat me drejtorin N.G.

Sipas aktgjykimit të kundërshtuar, përgjegjësia e S.F.t përcaktohet nga kontrata e tij e punësimit e nënshkruar me MTI-në. Me kontrollimin e procesverbalit të seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të shkresave të lëndës, kolegji ka vërtetuar se kontrata e punës e S.F.t kurrë nuk kishte qenë pjesë e provave në shqyrtimin gjyqësor as nuk ishte administruar në asnjë fazë të procedurës penale në këtë lëndë.

Lidhur me këtë, neni 361 (1) i KPP-së përcakton:

*“Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor” /neni 361 (1) i KPP-së*

Ndërsa, neni 8 i KPP-së specifikon:

*“Gjykata merr vendimin në bazë të provave të ekzaminuara dhe të verifikuara në shqyrtim gjyqësor” neni 8 (2), i KPP-së*

Kolegji i Gj/A-së pa asnjë dyshim e vërteton se gjykata e shkallës së parë, duke e bazuar aktgjykimin dënues në provat të cilat nuk janë prezantuar as nuk janë administruar në shqyrtim gjyqësor, i ka shkelur rëndë dispozitat e përmendura më lart të KPP-së.

Duke iu kthyer cilësimit të veprës penale, kolegji i Gj/A-së gjen se veprimi apo më saktësisht lëshimi i S.F.t, siç dokumentohet në shkresat e lëndës dhe administruar në shqyrtim gjyqësor, nuk i përmban elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, as nuk tërheq me vete kurrfarë përgjegjësie penale. Siç është theksuar me të drejtë nga mbrojtësi, asnjë prej kushteve të përcaktuara për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 të KPK-së, nuk korrespondon me rolin e S.F.t. Më saktësisht, ai nuk e ka tejkalluar autoritetin as nuk ka dështuar ta kryejë detyrën zyrtare, as nuk i ka shkaktuar dëm askujt, dhe mbi të gjitha, nuk ka pasur fare dashje, pasi që nuk ka qenë në dijeni rreth zhvillimeve dhe shumës së kontestuar të parave. Gjithçka kishte ndodhur larg syve dhe dijes së tij.

Kolegji i Gj/A-së konstaton se nuk është vërtetuar se S.F. ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar as individualisht as në bashkëkryerje.

Për këtë arsye, kolegji e miraton ankesën e ushtruar në emër të të pandehurit S.F. si dhe ankesën e tij individuale dhe e liron atë.

## **F. Çështjet e tjera**

### **Heshtja e të pandehurve**

Gjykata Themelore ka vendosur që mos t'iu japë vlerë provuese deklaratave të dëshmitarëve të cilët kanë heshtur në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata e Apelit konstaton se ashtu siç theksohet drejt në ankesën e Destan Rukiqit, deklaratat e të pandehurit S. F. të dhëna gjatë procedurës paraprake duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e Apelit është e mendimit se ky lëshim nuk ndikon në epilogun përfundimtar dhe në gjetjen e gjykatës së shkallës së dytë se S.F. nuk e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje me të tjerët. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit nuk do të futet në detaje rreth këtij lëshimi të Gjykatës Themelore. Megjithatë, Gjykata e Apelit e thekson se deklarata e të pandehurit në fazën e procedurës paraprake në përputhje me dispozitat ligjore (vërejtje e mirëfilltë) duhet të lexohet si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor, në rast se i pandehuri vendos të heshtë.

### **Konkluzion**

Kolegji konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri N.K e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së. Kolegji i Gj/A-së konfirmon se neni 422 (1) duhet të lexohet së bashku me nenin 31 të KPK-së, për shkak se mënyra si është kryer vepra penale tregon se kryerësi N. K. ka vepruar me persona të tjerë të cilët nuk janë akuzuar.

Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin e kundërshtuar lidhur me të pandehurin N.K si në dispozitivin e aktgjykimit duke ia shqiptuar dënimin në përputhje me nenin 51 të KPK-së.

Kolegji gjen se nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar se të pandehurit A.Z., S.H. dhe S.F. e kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 422 (1), lidhur me nenin 31 të KPK-së. Për këtë arsye, kolegji i Gj/A-së, në bazë të nenit 364 (1.3) të KPP-së i shfajëson të pandehurit A.Z., S.H. dhe S.F. dhe i liron ata nga obligimi për t'i paguar shpenzimet e procedurës të caktuara me aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR 144/13, të datës 21 shtator 2015.

Siç theksohet më lart, në bazë të nenit 401 të KPP-së dhe nenit 403 të KPP-së, Gjykata e Apelit

ka vendosur si në dispozitiv.

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim është përfunduar më datën 13 qershor 2016.

*Aktgjykimi është përpiluar në gjuhën angleze*

### **Kryetari i kolegjit**

---

Radostin Petrov, gjyqtar i EULEX-it

### **Anëtarët e kolegjit**

---

Hajnalka Veronika Karpati, gjyqtare e EULEX-it

---

Driton Muharremi, gjyqtar kosovar i Gj/A-së

### **Procesmbajtësja**

---

Vjollca Gërxhaliu-Kroçi, këshilltare ligjore e EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR nr. 603/15**

**20 maj 2016**

